



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

NR. 19 AKTI

NR. 26 VENDIMI

Tiranë, më 21.06.2018

V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja

Kryesuese

Xhensila Pine

Anëtare

Valbona Sanxhaktari

Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. John Leonardo, më datë 20.06.2018, ora 11:00, dhe më datë 21.06.2018, ora 11:30, në Pallatin e Kongreseve, kati i dytë, zhvilloi seancën dëgjimore dhe shpalljen e vendimit mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Z. Ilir Toska, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, kandidat për KLGJ, i pranishëm në seancën dëgjimore.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE :

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

RRETHANAT E ÇËSHTJES:

Z. Ilir Toska është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të tij si gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Duke qenë kandidat për anëtar i Këshillit të Lartë Gjyqësor, në bazë të nenit 276 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ai u është nënshtruar procedurave të rivlerësimit me përparësi.

Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e në vijim referuar si “Komisioni”) ka hedhur shortin më datë 30.11.2017, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit me përparësi nga trupi gjykues nr. 4.

Menjëherë pas hedhjes së shortit, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (këtu e më poshtë referuar si “ILDKPKI”), sipas neneve 30 - 33 të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (këtu e më poshtë referuar si “DSIK”), sipas neneve 34 - 39 të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Drejtësisë (këtu e më poshtë referuar si “KLD”), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016, së bashku me Formularin e Vetëvlerësimit Profesional, si dhe vendimet gjyqësore të përzgjedhura prej tij. Subjekti u kontaktua nëpërmjet adresës elektronike të deklaruar prej tij, përkatësisht ***, ***, për hetim të mëtejshëm, ku iu dërgua edhe pyetëtori i përgatitur nga Komisioni.

Me vendimin e trupit gjykues, datë 12.12.2017, është vendosur kryesuese znj. Etleda Çiftja, si dhe është deklaruar mospasja e konfliktit të interesit nga të gjithë anëtarët e trupit.

Më datë 31.05.2018 është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues, që do të kryente procesin e rivlerësimit për gjyqtarin, ndërsa subjekti ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.

Më datë 05.06.2018, trupi gjykues, bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitura nga relatori i çështjes, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak kryesisht për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Dh. Toska, bazuar në të tri kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë atë për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta. Trupi gjykues ngarkoi relatorin e çështjes për të njoftuar subjektin e rivlerësimit.

Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj. Ai paraqiti parashtrimet e tij lidhur me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit të kryer nga Komisioni.

Më datë 18.06.2018, në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Toska, në seancë dëgjimore në datën 20.06.2018, ora 11:00 paradite, në Pallatin e Kongreseve.

Më datë 20.06.2018 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, ishte prezent.

QËNDRIMI DHE MENDIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016. Ai ka zbatuar me përpikëri afatet e përcaktuara nga Komisioni, si dhe ka sjellë shpjegimet e nevojshme.

SEANCA DËGJIMORE

Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore më datë 20.06.2018. Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, më datë 20.06.2018, ora 10:00 paradite, në Sallën e Konferencave, në Pallatin e Kongreseve, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. John Leonardo.

Në këtë seancë, subjekti i rivlerësimit ishte prezent, ai dha shpjegimet e tij në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer. Në përfundim, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, kërkoi konfirmimin në detyrë.

PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë (a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë ILDKPKI-së në "Deklaratën për rivlerësimin

kalimtar, Vetting”; (b) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja; (c) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, (d) raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga KLD-ja, (e) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (ë) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (g) denoncimet nga publiku. Në mbështetje të dispozitave ligjore kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në mënyrë të pavarur dhe të paanshme, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, siç përcaktohet edhe në vendimet e Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2 dhe Nr. 78, të vitit 2017.

Komisioni, bazuar në nenin 50 të ligjit nr. 84/2016, gjatë hetimit të çështjes administroi:

- Dokumente të tjera shkresore, nga organet publike, përveç atyre që ka administruar ILDKPKI-ja.
- Dokumente të tjera shkresore, përveç atyre që ka administruar DSIK-ja.
- Deklarata, përgjigje dhe shpjegime nga ana e subjektit të rivlerësimit.
- Denoncime nga publiku.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Si pjesë e hetimit administrativ u vlerësuan dhe u shqyrtuan të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke u bazuar në sa më poshtë:

- Raportin e vlerësimit dhe dosjen nga ILDKPKI-ja;
- Dokumente të tjera shkresore, sipas parashikimeve të nenit 49, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016;
- Deklarata nga subjekti i rivlerësimit.

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Subjekti i deklaramit, z. Ilir Toska, ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33¹ të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtroi hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33/5/a të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ky institucion në raportin e tij ka konkluduar se:

- a. *Deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b. *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c. *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d. *Nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- e. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

¹Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaratimet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me këtë ligj, ligjin “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe Kodin e Procedurave Administrative.

Pavarësisht se, sipas kreut IV të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror të subjektit, Komisioni duhet të kryejë hetimin e tij të pavarur².

Prandaj, deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Toska, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë së deklaramëve në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë.

Për këtë arsye, nga relatori u ndërmorën hapat e mëposhtëm:

- U administruan të gjitha deklaratat periodike të subjektit të rivlerësimit të dorëzuara pranë ILDKPKI-së (2003 - 2017).
- Iu ngarkua këshilltarit ekonomik që të hartojë një bilanc ekonomik e financiar të subjektit dhe të japë një opinion nëse subjekti justifikon me të ardhurat e realizuara ndër vite dhe shpenzimet e kryera ndër vite pasuritë e deklaruara.
- Iu kërkua këshilltarit juridik të japë një opinion në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve juridike të kryera prej subjektit dhe nëse ka konflikt interesi në ndonjë rast.
- Iu kërkua organeve shtetërore publike e private që të konfirmojnë edhe një herë vërtetësinë e informacionit të përcjellë subjektit apo ILDKPKI-së.
- Iu kërkua subjektit në adresën elektronike të japë informacion shtesë sipas pyetjeve të dërguara.

Hetimit administrativ përfshiu pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme, pasurinë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, si dhe konfliktin e interesit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, në deklaratën e tij të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe mbas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja, si dhe nga Komisioni, rezultojnë se ka në pronësi vetëm një pasuri të paluajtshme:

➤ **Apartament banimi**³, me sipërfaqe 83.31 m², me adresë Rr. “***”, Tiranë, blerë në vitin 2005, në vlerën 50.292 euro, dhe rivlerësuar në ZVRPP Tiranë, në vitin 2017, në shumën 8.164.380 lekë.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie:

- Kursimet familjare në vlerën 16.000 euro;
- Hua prej 12.000 eurosh, e marrë nga shtetasja F.Gj. (K.)⁴.
- Një kredi e përfutur për trajtimin e funksionarëve të lartë të shtetit, dhënë nga “Raiffeisen Bank”⁵, në shumën 5.000.000 lekë, me interes 3 %, me afat 300 muaj⁶.

² “41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr.84/2016, rezultojnë se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

³Blerë sipas kontratës së sipërmarrjes nr. *** , datë 15.07.2005, dhe kontratës së shitblerjes nr. *** , datë 20.12.2012, në vlerën 50.292 euro, në bashkëpronësi 50 % me bashkëshorten, znj. M.T.

⁴Kontrata e huadhënies, datë 20.09.2005. Më datë 24.04.2006 është lëshuar deklaratë noteriale nr. *** me deklarues Ilir Toska e F.Gj (K), ku thuhet se huaja është shlyer në afat.

⁵Kontratë e kredisë bankare nr. *** , datë 04.10.2005, shih në dosje.

⁶Balanca e kredisë më datë 13.01.2017 është 3.202.501 lekë.

Hetimi i kryer nga Komisioni

Hetimi i kryer nga Komisioni, kryesisht, u shtri te procedura e kryerjes së këtij transaksioni, si dhe burimi i krijimit të kësaj pasurie.

Komisioni iu drejtua ZVRPP-së Tiranë⁷, duke i kërkuar kopje të plotë të të gjithë transaksionit të kryer për këtë apartament, qysh prej fillimit; kontratën fillestare hipotekore, që shërbeu për marrjen e kredisë për trajtimin e funksionarëve të lartë në “Raiffeisen Bank” nga subjekti i rivlerësimit.

“Raiffeisen Bank” vuri në dispozicion⁸ kopje të kontratës hipotekore të vitit 2005, me palë shtetasit L. A. dhe A. A., të cilët kanë hipotekuar një apartament me sipërfaqe 112 m², në rrugën “****”, Tiranë. Hipoteka është vendosur si garanci deri në përmbushjen e plotë të detyrimeve të kredimarrësit Ilir Toska. Duke qenë se ky fakt nuk ishte bërë me dije më parë, Komisioni vendos të hetojë për këtë fakt të ri.

Nga verifikimi i kryer për këtë shtetas, rezulton se L. A. është avokat i Dhomës së Avokatisë Tiranë, që prej vitit 2007, më parë ai ka qenë oficer i Policisë Gjyqësore pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Për arsye të kësaj marrëdhënieje mes z. Toska dhe shtetasit L. A., iu kërkuua zyrtarisht informacion Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Ndërsa Gjykatës së Apelit Tiranë, ku subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e tij si gjyqtar, dërgimi i të gjitha vendimeve të mundshme të Gjykatës (nëse ka), ku palë ka qenë avokati L. A. dhe gjyqtar Z. Ilir Toska, për periudhën 2007 deri në vitin 2013 (kur kontrata e kolateralit në bankë është zëvendësuar). Verifikimi u bë për të konstatuar nëse subjekti i rivlerësimit ka qenë në kushtet e konfliktit të interesit me këtë shtetas.

Gjykata e Apelit Tiranë dërgoi bashkëlidhur 19 vendime, për çështje gjyqësore me anëtar gjyqtarin Ilir Toska dhe avokat L. A., për periudhën 2007 - 2013.

Lidhur me këtë material mbi konfliktin e mundshëm të interesit mes subjektit të rivlerësimit dhe avokatit L. A., u pyet Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, si autoritet qendror përgjegjës, për zbatimin e ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

Nga shqyrtimi në tërësi i akteve, ILDKPKI-ja ka konkluduar⁹ se:

Së pari: nuk gjendemi para një *konflikti faktik të interesit*, pasi interesi faktik i zyrtarit nuk rezulton se ka ndikuar apo mund të ndikojë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësi shtetërore në kuptim të nenit 3, pika 4, germa “a”, të ligjit.

Së dyti: parimi i *interesit të supozuar* të gjyqtarit, që mund të ngrëjë dyshime për ekzistencën e një konflikti në dukje të interesit, nuk ka ndodhur dhe as ka pasur mundësi të ndodhë, pasi vendimet gjyqësore nuk kanë asnjë ndikim mbi interesat e supozuara të gjyqtarit dhe se nuk rezulton ndonjë lidhje mes interesit të supozuar dhe vendimmarrjes gjyqësore konkrete, të tilla që ato, për këtë shkak dhe vetëm për të, të jenë të padrejta.

Së treti: nuk gjendemi përpara një *konflikti të mundshëm të interesit*, sepse interesi i supozuar nuk ekziston tashmë dhe as nuk ekziston mundësia që në të ardhmen të vihet në diskutim

⁷Me shkresën nr. *** prot., datë 06.02.2018, drejtuar ZVRPP-së.

⁸Shkresa nr. *** prot., datë 16.02.2018, shih në dosje.

⁹Shih në dosje, shkresa nr. *** , datë 23.04.2018, kthim përgjigjeje.

shfaqja ose jo e një interesi faktik ose konflikti në dukje, pasi kontrata e kolateralit në bankë është zëvendësuar.

Në përfundim, ILDKPKI-ja arrin në përfundimin se: *“Nuk rezulton dhe nuk provohet që z. Ilir Toska, gjyqtar i Gjykatës së Apelit, të ketë ushtruar funksionin e vet publik në kushtet e konfliktit të interesit.”*

U pyet nëpërmjet *e-mail*-it edhe subjekti i rivlerësimit, i cili dha sqarimet e duhura lidhur me këtë çështje, të cilat ishin bindëse për Komisionin.

U verifikua vlefshmëria juridike e të gjitha kontratave të lidhura në funksion të banesës dhe u konstatua se ato janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji, si dhe kanë sjellë pasojat juridike të deklaruara.

Si burimi i të ardhurave për blerjen e banesës kanë shërbyer kursimet e deklaruara nga subjekti, të cilat i mbante *cash* në banesë¹⁰ dhe që rezultojnë të jenë krijuar nga kursimet nga pagat ndër vite, si dhe shitja e një apartamenti në Elbasan (shtëpia e prindërve), dhe të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike pranë ILDKPKI-së.

Po ashtu, burim ka qenë edhe huaja e datës 20.09.2005, e cila është zëvendësuar/likuiduar brenda një viti nga subjekti nëpërmjet shumës që ka përfutur nga kredia e butë.

Burim ka qenë edhe kredia e marrë në “Raiffeisen Bank”, në vlerën 5.000.000 lekë, më datë 12.10.2005 (disbursuar lekët).

Pas analizës së thelluar ekonomike, konstatohet se vlera e kursyer përputhet me të ardhurat e siguruar ndër vite, duke u klasifikuar si burim i ligjshëm, pasi subjekti i rivlerësimit ka provuar origjinën, si dhe e ka shoqëruar me dokumente. Po ashtu, rezulton se është shlyer huaja e marrë nga shtetasja F. Gj. (K.), nga të ardhurat e përfutura nga kredia.

U pyet subjekti i rivlerësimit¹¹ *“Nëse dispononte fatura të pagesave të kryera për blerjen e apartamentit, të cilat mund të na vihen në dispozicion”*. Ndërsa subjekti dërgoi në përgjigjen e tij, të datës 29.03.2018, deklaratën noteriale¹² mes tij dhe shoqërisë për shlyerjen plotësisht të vlerës prej 50.292 eurosh për blerjen e banesës, kontratën e huadhënies dhe deklaratën noteriale për marrjen e borxhit kumatës dhe shlyerjen e tij, kartelën për blerjen e apartamentit dhe kështu, si edhe mandate të pagesave të kryera që ai dispononte.

Subjekti sqaroi mbi kryerjen e transaksioneve për blerjen e apartamentit, me data të sakta dhe mandate pagese. Përputhen deklaratimet e subjektit të rivlerësimit me hetimin e kryer nga Komisioni dhe deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit në deklarinimin periodik vjetor (2005 - 2006).

➤ *Autoveturë “DaimlerChrysler”*¹³, prodhim i vitit 1999, në vlerën 1.000.000 lekë, subjekti i rivlerësimit është pronar i vetëm.

Burimi i kësaj pasurie:

- Burim i blerjes së automjetit janë kursimet familjare.

¹⁰Deklarimi v. 2004 gjendja *cash*: 2 600 000 lekë.

¹¹Pyetësori, datë 27.3.2018.

¹²Deklaratë noteriale, nr. *** rep, nr. *** kol., datë 07.12.2012.

¹³Blerë me kontratën nr. *** më datë 09.11.2007, nga shtetasi S.M

Hetimi i kryer nga KPK

Pas analizës ekonomike, konstatohet se vlera e përdorur për blerjen e automjetit ka ardhur nga kursimet e tij, si zvogëlim i gjendjeve *cash* të akumuluar, referuar deklarimeve të subjektit.

Nga analiza financiare e kryer për këtë pasuri, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme për ta blerë automjetin.

➤ Hetimi administrativ mbi pasurinë monetare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur

Për këtë është kërkuar informacion nga institucionet bankare, nga të cilat rezulton se pasuria monetare e deklaruar në “Deklaratën për rivlerësimin kalimtar, Vetting” ka ardhur si rezultat i shndërrimit të kursimeve *cash* të akumuluar periodikisht në shtëpi dhe të kaluara në llogari bankare.

Rezulton se të ardhurat e subjektit të rivlerësimit janë vetëm ato nga paga si gjyqtar dhe të bashkëshortes së tij janë ato nga paga si pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë dhe të ardhura nga disa kontrata me laboratorë mjekësorë privatë.

U verifikuan udhëtimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, të cilat rezultuan mesatarisht 4 - 5 udhëtime në vit me familjen.

U konstatua se subjekti i rivlerësimit justifikon shpenzimet jetësore familjare të kryera ndër vite, dhe se ato janë të mbuluara plotësisht nga të ardhura nga burimet e ligjshme.

Hetimi administrativ kryesisht, i kryer nga Komisioni, u shtri edhe më tej nga ai i deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit.

Për këtë është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Ministria e Drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, Drejtoria e Pastrimit të Parave, Ujësjellës-Kanalizime Tiranë.

Nuk rezulton nga ndonjë burim që ky subjekt të ketë pasuri të paluajtshme, të fshehura apo të padeklaruara, të mbajtura nga persona të tjerë.

Subjektit të rivlerësimit iu dërgua nëpërmjet adresës zyrtare të *e-mail*-it edhe një pyetësor-tip dhe nga përgjigjet e këtij pyetësori, deklaratimet ishin korrekte dhe në përputhje me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit.

Hetimi administrativ në lidhje me konfliktin e interesit

Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, është subjekt i ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” dhe i ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”.

Për këtë subjekt nuk pati ndonjë rast të konstatimit të konfliktit të interesit, që të ishte pjesë e hetimit nga Komisioni, përveç atij të sipërpërmendur. Për rastin e përmendur më lart vlerësojmë se nuk jemi në kushtet e konfliktit të interesit, pasi në nenin 5 të ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, të ndryshuar, janë përcaktuar në mënyrë shteruese interesat private të zyrtarit, prania e të cilave në vendimmarrjet e zyrtarit bën shkak që vendimmarrja të konsiderohet vendimmarrje e marrë në kushtet e konfliktit të interesit. Kufizimet e interesave private, të përcaktuara shprehimisht në ligj, zbatohen së bashku me kufizimet e të njëjtit interes privat të përcaktuar shprehimisht në një ligj tjetër, sipas parimit që zbatohet ai kufizim, që është më i rreptë. Nëse do të përkufizojmë interesin privat, në rastin konkret të gjyqtarit, vërejmë se aktivizimi i hipotekës për pasojat që ajo sjell ndodhin në rastin kur kreditori nuk përmbush

detyrimin dhe, referuar të drejtës së hipotekës, kreditori ka të drejtën e ekzekutimit të menjëhershëm të detyrimit. Nga sa rezulton nga hetimi, subjekti ka përmbushur me përpikëri detyrimet për pagesat ndaj shoqërisë dhe, për pasojë, shlyerjen e borxhit. Kështu, marrëdhënia e hipotekës nuk ka sjellë dhe as nuk mund të passillte asnjë përfitim pasuror në raportin mes gjyqtarit dhe shtetasit L. A. Nga analiza e situatës rezulton se hipoteka e vendosur ka shërbyer vetëm për përmbushjen e një kushti të bankës dhe për asnjë rast nuk rezulton që gjyqtari mund të ketë pasur një interes privat që të çonte në ndonjë përfitim për shkak të detyrës, aq më tepër nisur edhe nga deklaratimet e tij se ai nuk ka pasur ndonjë shoqëri të theksuar me këtë shtetas dhe as marrëdhënie miqësore ndër vite. Për rrjedhojë, vendimet e gjyqtarit, në trupat ku ky shtetas ka qenë përfaqësues i palës, kanë qenë vendime të organit kolegjal për të cilat vendimmarrja ka qenë unanime dhe ku rezulton se gjyqtari nuk ka pasur ndonjë kompetencë thelbësore dhe përcaktuese konkrete.

Përgjithësisht, në 14 raste, këto vendimmarrje gjyqësore të organit kolegjal, ku ka marrë pjesë dhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, kanë të bëjnë me masa sigurimi personal në lëndë penale, përkundrejt individëve të dyshuar si autorë veprash penale, vendimmarrje të cilat parimisht nuk mund të thuhet se determinojnë procesin penal ndaj këtyre individëve, ndërkohë që nuk ka ndonjë të dhënë faktike që ato të kenë determinuar proceset penale në ato raste. Duket që ato janë çështje gjyqësore rutinë, për vepra dhe autorë me rrezikshmëri jo të theksuar, të vogël apo të moderuar.

Vetëm në një rast, organi kolegjal, ku ka marrë pjesë dhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, ka ndryshuar vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë), ndërsa në rastin tjetër është vendosur mospranimi i ankimit të të akuzuarit.

Në dy rastet e fundit, këto vendimmarrje gjyqësore të organit kolegjal, ku ka marrë pjesë edhe zyrtari/gjyqtari në fjalë, kanë të bëjnë me mosmarrëveshje civile, ku në një rast Gjykata e Apelit ka dhënë vendim në disfavor të palës së përfaqësuar nga avokati L. A., duke prishur vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë), ndërsa në rastin tjetër, Gjykata e Apelit ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës më të ulët (Gjykatës së Shkallës së Parë).

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë.

Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, proporcionalitetit, barazisë së palëve, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të pasurisë, arrin në përfundimin se:

“Nga kontrolli i pasurisë ndaj subjektit të rivlerësimit nuk u evidentuan pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, se ai ka kryer deklaram që është i saktë dhe në përputhje me ligjin dhe ka pasur burime financiare të ligjshme e të mjaftueshme. Pasuria e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur rezulton të jetë e ligjshme, nuk ka deklaram të rremë apo të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë. Subjekti nuk gjendet në situatë konflikti interesi.”

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar.

B. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KONTROLLIT TË FIGURËS

Sipas nenit 34 të ligjit nr. 84/2016: *“Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.”*

Nga ana e subjektit është plotësuar dhe dorëzuar deklarata për kontrollin e figurës, formulari është administruar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar në lidhje vërtetësinë e të dhënave të deklaruara nga subjekti, si edhe të kontakteve të papërshtatshme, sipas nenit 39 të ligjit¹⁴. Nga ana e kësaj drejtorie është përpiluar raporti përkatës, i cili i është përcjellë më pas Komisionit për t'u vlerësuar.

DSIK-ja, konform nenit 36 të ligjit “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”¹⁵, ka administruar informacion që disponohet për subjektin e rivlerësimit nga institucionet ligjzbatuese, SHISH, SHKÇBA, DSIK.

Ajo ka dërguar një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ku rezulton se: *Për subjektin e rivlerësimit, z. Ilir Toska, administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.*

Informacioni i ardhur nga institucioni i verifikimit bën me dije se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, Z. Ilir Toska, disponohen të dhëna të vitit 2004, nga të cilat ngrihen dyshime për përfshirje në korrupsion pasiv.

Subjekti i rivlerësimit, me detyrë kryetar i inspektimit në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, dyshohet të jetë përfshirë në një rast korrupsioni pasiv, që lidhet me dhënien e mitës nga një gjyqtar për dy inspektorë të KLD-së, njëri prej të cilëve është subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska. Mita u dha me ndërmjetësimin e një punonjësi të Ministrisë së Rendit Publik. Në atë periudhë, inspektorët e KLD-së ishin të ngarkuar për kontrollin e një çështjeje civile të gjykuar nga gjyqtari mitëdhënës.

Informacionet që disponohen në ngarkim të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Toska, për implikimin e tij në një veprimtari korruptive, duke konstatuar se ekziston një kontakt i papërshtatshëm, sipas përcaktimit të pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në formën e një takimi të qëllimshëm në papajtueshmëri me ushtrimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

Referuar këtij informacioni, subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, rezulton individ i mundshëm për t'u vënë nën presion nga struktura kriminale, sipas përcaktimit të germës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016.

¹⁴“Procedura për kontrollin e figurës 1. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, në bashkëpunim me grupin e punës, brenda 60 ditëve nga konstituimi i grupit të punës, verifikon nëse informacioni është i saktë dhe nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar. Në përfundim të afatit 60-ditor, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar mund t'i kërkojë Komisionit një zgjatje 30-ditore të afatit të verifikimit, në rast se është kërkuar informacion nga shtete të tjera. 2. Brenda 10 ditëve nga përfundimi i kontrollit, Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, pas përgatitjes nga grupi i punës të dokumentit/raportit, ia paraqet atë Komisionit. Ky dokument/raport përcakton nëse subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës, në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi; nëse ka informacion në deklarimin e tij ose gjetkë, që tregon se subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, si dhe konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë e tij për vazhdimin ose jo të detyrës. Ky dokument përmban informacion mbi kontaktet dhe kushtet e parashikuara në nenin 38 të këtij ligji. Informacioni nuk bëhet publik nëse ai rrezikon sigurinë e burimit, ose për shkak të një kushti të përcaktuar nga qeveria e një shteti tjetër”.

¹⁵“Struktura përgjegjëse për kontrollin e figurës 1. Institucionet e rivlerësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar janë autoriteti përgjegjës për kontrollin e figurës. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka të drejtë të caktojë një personel shtesë, për të kryer kontrollin e figurës për qëllim të këtij ligji. Personat që kryejnë kontrollin e figurës pëmbushin standardet e zbatueshme për mbrojtjen e privatësisë dhe të konfidencialitetit në detyrë. 2. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, Shërbimi Informativ Shtetëror (SHISH) dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave (SHKÇBA) pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme, krijojnë një grup pune për zbatimin e këtij ligji. Këto struktura mund të caktojnë personel për të mbështetur grupin e punës për një periudhë kohe jo më pak se 1 vit. 3. Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar, me kërkesë të grupit të punës ose të institucioneve të rivlerësimit, ka të drejtë të komunikojë me shtetet e tjera për të marrë informacionin e nevojshëm për personat e përfshirë në krimin e organizuar ose për personat e dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar për qëllim të këtij ligji.”

Në bazë të pikës 8 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, që përfshin veprat penale bazuar në nenin 75/a të Kodit Penal, subjekti i rivlerësimit është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit pasiv të gjyqtarit, kryer në bashkëpunim.

Merret në konsideratë si rrethanë lehtësuese fakti që informacioni i institucionit verifikues daton në vitin 2004, pra para periudhës së përcaktuar në ligj - 01.01.2012.

Sa më sipër, Grupi i Punës i DSIK-së konstaton papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Dh.Toska.

Në vijim të procesit të verifikimit të figurës, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe garantimin e të drejtave të subjektit të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor, në kuptim të nenit DH të Kushtetutës, si dhe referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 2/2017, Komisioni mund të kryejë hetim të thelluar.

“41.Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga KPK-ja, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

Raporti i Grupit të Punës së DSIK-së (informacioni që përmbante) iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e rrethanave që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanave lehtësuese, të rrjedhura nga informacioni që kishte marrë Grupi i Punës dhe kishin çuar në **konstatimin e papërshtatshmërisë për vazhdimin e detyrës**, si dhe vërtetësisë së ngjarjes konkrete, me qëllim gjetjen e provave, për realizimin e një procesi të rregullt ligjor.

Hetimi i pastërtisë së figurës u shtri më tej nga ana e Komisionit, që zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht.

Nga relatori u krye verifikimi i informacionit që kishte mbledhur DSIK-ja për përgatitjen e këtij raporti dhe rezultoi se ai vinte vetëm nga një burim dhe referonte se ngrihen dyshime për përfshirje në korrupsion pasiv të gjyqtarit në vitin 2004.

Sipas Kushtetutës dhe ligjit, kontrolli i figurës nis me deklaratën e detajuar për figurën, që mbulon periudhën nga 1 janari 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit, pra subjekti i rivlerësimit deklaroi për kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe.

Mënyra e kontrollit të figurës detajohet brenda parimeve kushtetuese dhe ligjit nr. 84/2016 që, në nenin 34 të tij, përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës: *“Objekti i kontrollit të figurës është verifikimi i deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.*

Standardet e kontrollit të figurës i përcakton vetë ligji. Gjithë procesi duhet të zhvillohet bazuar **në prova të sakta në mënyrë objektive**. Referuar nenit 38, “Standardet e kontrollit të figurës”, pika 3, “*Kontrolli i figurës përfshin vlerësimin e provave dhe informacioneve që lidhen me rrethanat që merren parasysh në konstatimet, sipas parashikimeve të pikave 4 dhe 6, të këtij neni, dhe rrethanat lehtësuese, sipas parashikimeve të pikave 5 dhe 7 të këtij neni. Vlerësimi duhet të përmbajë rrethanat që merren parasysh në konstatim, si dhe rrethanat lehtësuese të këtij konstatimi. Nëse vlerësimi nuk përmban elementet e parashikuara në këtë paragraf, konsiderohet i paplotë.*”

Rrethanat ku duhet të bazohet vlerësimi sa i përket kontrollit të figurës, përcaktohen në paragrafin 4 të nenit 38, të grupuara në 5 kategori:

- a) *subjekti i rivlerësimit është fotografuar, ose kur një dëshmitar përshkruan një takim me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- b) *subjekti i rivlerësimit ose personi i lidhur me të ka pasur një komunikim jorastësor me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- c) *subjekti i rivlerësimit ose një person i lidhur me të ka shkëmbyer para, favore, dhurata ose pasuri me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- ç) *subjekti i rivlerësimit ka lidhje të ngushta me një person të përfshirë në krimin e organizuar;*
- d) *subjekti i rivlerësimit merr pjesë ose është i pranishëm në takime me një ose më shumë persona të përfshirë në krimin e organizuar. Anëtarësia e dyshuar e personit në krimin e organizuar duhet të jetë e njohur, e publikuar, ose të jetë një çështje e dokumentuar në regjistrat përkatës.*

Në këtë rast, informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, prandaj ai konsiderohet i paplotë.

Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet ta kryejë atë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij.

Në vijim të kësaj analize, u dërgua një shkresë¹⁶ pranë DSIK-së me shpjegimet dhe argumentet e thëna edhe më lart, ku kërkohet që ajo të shikojë edhe një herë raportin e saj, në frymën e ligjit dhe të Kushtetutës.

Po ashtu, në vijim të pikës 3 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 50 të ligjit nr. 84/2016 dhe në vijim të vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, iu drejtuam SHISH-it, me kërkesën për informacion të mëtejshëm lidhur me këtë rast, me qëllim garantimin e provave dhe krijimin e bindjes së brendshme, lidhur me komponentin e vlerësimit të figurës për këtë subjekt rivlerësimi.

Me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe kushtetues, vlerësohet si shumë i rëndësishëm **administrimi i provave dhe fakteve të nevojshme për një vendimmarrje të drejtë**.

DSIK-ja iu përgjigj shkresës sonë në datën 10.4.2018. Në këtë shkresë, ajo sqaronte se nga verifikimi i kryer pas kërkesës sonë për rishikimin e raportit, pas verifikimit shtesë të bërë, rikonfirmon konstatimin për papërshtatshmërinë e ushtrimit të detyrës për subjektin e

¹⁶ Shkresa nr. *** prot., datë ***, sekret, shiko në dosje.

rivlerësimit, duke marrë për bazë vetëm informacionin që ajo dispononte për përfshirjen e këtij gjyqtari në veprime korruptive dhe duke vlerësuar se koncepti thelbësor përcaktues i integritetit profesional të subjektit të rivlerësimit është sistemi i vlerave që tregon për pastërtinë e figurës së gjithsecilit prej tyre.

Duke qenë se informacioni ishte i vitit 2004, nuk kishte shumë detaje, por as nuk mund të konfirmohej se ai ishte nga burime të besueshme dhe me akses, por se ai ngrihej mbi dyshime për përfshirje të gjyqtarit (asaj kohe kryeinspektor) në veprime korruptive.

Referuar informacionit shpjegues mbi terminologjinë e përdorur, “*ngrihen dyshime*” -përdoret kur veprimtaria del nga një e dhënë, e cila duhet të vërtetohet në vazhdimësi.

Referuar informacionit sekret të administruar për ngjarjen, nuk u krijua bindja që gjyqtari të ishte i përfshirë në atë ngjarje dhe as nuk mund të provohej lidhja e tij me “kontakte të papërshtatshme”, ku sipas pikës 6 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, përcaktohet se: “*Kontakt i papërshtatshëm*” është një takim, komunikim elektronik ose çfarëdolloj mënyre tjetër takimi i qëllimshëm, që nuk është në pajtim me ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht nëse vendosen marrëdhënie biznesi, në kuptim të pikës 9 të këtij neni, ose ndonjë marrëdhënie tjetër”.

Në këto kushte, u konsiderua e nevojshme të pyetej subjekti i rivlerësimit drejtpërdrejt lidhur me ngjarjen.

Më datë 23.04.2018, nga Komisioni u pyet gjyqtari Toska, si vijon:

“I nderuar zoti gjyqtar,

Komisioni gjatë procesit të hetimit kryesisht ka edhe tri pyetje për ju, për të cilat do të vlerësonim nëse do të përgjigjeshit brenda dy ditëve.

- 1. A keni qenë ju dhe z. ***, inspektor i KLD-së, të përfshirë në kontrollin e një çështjeje civile me objekt “pronësi banese”, nga gjyqtari i Rrethit Gjyqësor Sarandë, z.***, në vitin 2004, kur ushtronit funksionin e kryeinspektorit?*
- 2. A keni hartuar një raport në përfundim të kësaj procedure dhe cili ishte rezultati i tij?*
- 3. A mund të na e vini në dispozicion një kopje të aktkontrollit të ushtruar nga ana juaj?*

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit”.

Subjekti i rivlerësimit u përgjigj brenda një kohe të shkurtër, duke u shprehur se:

*“...Pas përfundimit të verifikimeve nga inspektori ***, për të tri ankesat, ndaj gjyqtarit ***, unë, në cilësinë e kryeinspektorit, bazuar në Rregulloren e Brendshme të Inspektoratit, më datë 23.03.2004 kam përgatitur me shkrim relacionet përkatëse për çdo rast verifikimi, ku për të tria ato kam shprehur mendimin se materialet duhet t’i dërgoheshin ministrit të Drejtësisë, për të gjykuar për procedimin disiplinor të gjyqtarit ***, pasi referuar gjetjeve nga verifikimet, në veprimtarinë gjyqësore dhe jashtëgjyqësore të gjyqtarit në fjalë, evidentoheshin shkelje të ligjit që, në vlerësimin tim, përbënin shkelje disiplinore sipas ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”.*

*Më tej, po sipas Rregullores së Brendshme të Inspektoratit, rastet e verifikimit si më lart ndaj gjyqtarit ***, si dhe në vlerësimin tim në cilësinë e kryeinspektorit, ia kam relatuar zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. I.P.*

Pas miratimit të zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, konform ligjit nr. 8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”,

relacionet dhe praktikat dokumentare të verifikimeve si më lart, me shkresën nr. *** prot., datë 25.03.2004, të zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i janë përcjellë ministrit të Drejtësisë, si autoriteti i vetëm publik që kishte, sipas ligjit, nismën e ushtrimit të procedimit disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit, për të gjykuar ai për procedimin disiplinor ndaj gjyqtarit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, z. ***.

Mbas dërgimit të materialeve si më lart ministrit të Drejtësisë, nga sa kujtoj, një ose dy ditë më vonë, në ambientet e Këshillit të Lartë të Drejtësisë është përhapur lajmi se Shërbimi Informativ Shtetëror u kishte dërguar autoriteteve më të larta shtetërore, Presidentit të Republikës njëherazi dhe kryetar i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, z. Alfred Moisiu, ministrit të Drejtësisë, z. Fatmir Xhafaj dhe ministrit të Rendit Publik, z. Igli Toska, një material, regjistrim audio ose audioviziv, kohën, vendin dhe përmbajtjen e vërtetë të të cilit unë nuk e di as sot. Thuhej se ishte një regjistrim komprometues, ku ishin të përfshirë gjyqtari *** dhe shtetasi Y. M., vëllai i ankuesit si më lart E. M., që lidhej me verifikimin e ankesës së këtij të fundit nga inspektori *** i Inspektoratit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë. Në atë periudhë, rreth 40-ditore, të punës sime si kryeinspektor, nuk kam pasur asnjë kontakt me gjyqtarin *** dhe shtetasit në fjalë, mbasi veprimet verifikuese, marrja e sqarimeve dhe dokumentimi i tyre, kryheshin nga inspektori përkatës.

Në dijeninë time, ky material i Shërbimit Informativ Shtetëror është trajtuar nga autoritetet e larta shtetërore vendimmarrëse si më sipër, ndërsa kam mësuar se, pas kësaj, shtetasi Y. M. është larguar nga puna. Ndërsa për inspektorin *** nuk ka pasur asnjë veprim ligjor.

Nga ana tjetër, bazuar në materialet e dërguara nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Ministri i Drejtësisë, bazuar në nenin 31/3 të ligjit nr.8811, datë 17.05.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. *** prot., datë 23.06.2004, i ka kërkuar Këshillit të Lartë të Drejtësisë procedimin disiplinor të gjyqtarit *** dhe, bazuar në nenin 42/5 të ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ka propozuar marrjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra” ndaj këtij gjyqtari.

Procedimi disiplinor ndaj gjyqtarit është shqyrtuar nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë në mbledhjen e datës 21.12.2004, ku në përfundim të shqyrtimit, me vendimin nr. ***, datë 21.12.2004, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me unanimitet, ka vendosur që “Gjyqtarit ***, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, për kryerjen e veprimeve në kundërshtim me përmbushjen e rregullt të detyrës, t’i jepet masa disiplinore “shkarkim nga detyra”.

Ndaj këtij vendimi të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, gjyqtari ka paraqitur ankim në Gjykatën e Lartë.

Në gjykimin e çështjes në Gjykatën e Lartë, vendimin e Këshillit të Lartë të Drejtësisë si më lart ndaj gjyqtarit e kam mbrojtur unë, së bashku me një inspektor, si përfaqësues të autorizuar të Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Në përfundim të këtij gjykimi, Gjykata e Lartë, me vendimin nr. ***, datë 08.03.2006, me shumicë votash (7 pro dhe 5 kundër), ka vendosur “Shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 21.12.2004, të Këshillit të Lartë të Drejtësisë, për shkarkimin nga detyra të gjyqtarit ***, si antikushtetues”, me arsyetimin se, përtej përcaktimeve të ligjit organit të pushtetit gjyqësor (ligjit nr. 8436, datë 28.12.1998, “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”), nga analizimi i shkeljeve të gjyqtarit në aspektin kushtetues, konstatohet se ato nuk gjenin mbështetje në asnjë nga rastet e parashikuara në nenin 147/6 të Kushtetutës, sipas të cilit “Gjyqtari mund të shkarkohet nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë për kryerjen e një krimi, për paaftësi mendore a fizike, për akte e sjellje që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose për pamjaftueshmëri profesionale”.

Pas marrjes së këtij informacioni nga subjekti i rivlerësimit, u administruan edhe praktikat e verifikimit të tri ankesave, përkatësisht të zotit E. M., të Ministrit të Rendit Publik, si dhe

shtetasit F.S. dhe B. S., materialet e ILDKPKI-së së vitit 2004, si dhe materialet nga procedimi disiplinor, nga të cilat arrihet lehtësisht në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, nuk ka qenë në kushtet e parashikuara në raportin e DSIK-së, pasi nuk u provua se ka pasur një lidhje mes subjektit të rivlerësimit dhe personave të përfshirë në këtë proces, e cila të kishte çuar në manipulimin e situatës për arsye të mitëmarrjes. As nuk u konstatua se subjekti i rivlerësimit të kishte ndonjë kontakt të papërshtatshëm, pasi në materiale e disponuara vërehet lehtësisht se kanë qenë persona të tjerë ata që mund të kenë tentuar për të ndërhyrë në këtë proces dhe se, në asnjë rast, subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të ndryshojë apo të modifikojë vërtetësinë e materialit/relacionit të paraqitur, përkundrazi, ai ka kryer me përgjegjësi dhe korrektesë punën e tij dhe konform ligjit.

Në parashtrimet e tij, subjekti i rivlerësimit sqaron se:

“Gjithashtu, dua të bëj prezent faktin se unë jam emëruar gjyqtar i Gjykatës së Apelit Tiranë, me propozim të KLD-së, me dekret të ish-Presidentit të Republikës, z. Alfred Moisiu, në prill 2007, pikërisht me dekret të atij Presidenti të Republikës, të cilit SHISH-i i ka dërguar atë informacion në vitin 2004. Nga ana tjetër, është fakt i njohur se z. Moisiu, në funksionin e Presidentit të Republikës, në rastin e emërimeve të gjyqtarëve, merrte informacione nga shërbimet inteligjente, gjë të cilën ai e ka pranuar edhe publikisht.”

Më datë 18.04.2007, KLD i propozon Presidentit të Republikës emërimin e zotit Ilir Toska gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë. Presidenti i Republikës, z. Alfred Moisiu, me dekretin e datës 30.04.2007, emëron zotin Ilir Toska gjyqtar në Gjykatën e Apelit Tiranë.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës.

Në përfundim, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit i) deklaratën për kontrollin e figurës; ii) raportin e DSIK-së, ii) si dhe zhvilloi një hetim të thelluar kryesisht, bazuar në parimin e transparencës, procesit të rregullt ligjor, eficiencës, barazisë së palëve në procesin gjyqësor, në lidhje me rubrikën e vlerësimit të figurës, arrin në përfundimin se:

Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua në ndonjë formë që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, nuk është i përfshirë, si dhe nuk është i vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë ai është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. PROCESI I RIVLERËSIMIT TË KRITERIT ETIKO-PROFESIONAL

Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- Raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Inspektorati i KLD-së;
- Informacionin e marrë nga burime të ligjshme;
- Kriteret e vlerësimit, të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Këshilli i Lartë i Drejtësisë (KLD) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

Raporti për këtë subjekt të rivlerësimit është i arsyetuar dhe përmban një analizë të hollësishme të të gjithë veprimtarisë profesionale dhe sjelljes etike. Në përputhje me ligjin, janë administruar të dhëna në lidhje me formimin profesional, karrierën, të dhënat statistikore që lidhen me veprimtarinë në përgjegjësinë e subjektit të rivlerësimit.

Aftësitë profesionale

Njohuritë ligjore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Ka njohuri për rëndësinë e natyrës së mosmarrëveshjes lidhur me zgjidhjen e çështjes, si dhe identifikon saktë gjykatën kompetente nga pikëpamja e lëndës. Identifikon rastet kur dispozitat e kontratat së kredisë, ndërmjetësimit dhe shitjes kanë fuqinë e ligjit dhe i përdor ato për zgjidhjen e çështjes. Gjithashtu, ai i kushton rëndësi parimit të veprimit të ligjit në kohë, duke identifikuar rastet kur ligji material i hershëm në kohë është i zbatueshëm dhe duke e referuar saktë përmbajtjen e tij. Në çështjet penale, i kushton rëndësi të gjitha elementeve të veprës penale, si dhe ndalet me kujdes te dënimi penal, duke treguar njohuri edhe për alternativat e dënimit me burgim. Në vendimet gjyqësore nuk përdor rregullisht parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, ku rastet janë sporadike: në dosjen nr. 3 është përdorur prej tij parimi i veprimit të ligjit në hapësirë dhe në kohë. Në ndonjë rast, në funksion të zbatimit të ligjit, ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuese e Gjykatës së Lartë dhe nga praktika e Gjykatës së Lartë. Në tri dokumentet ligjore dhe pesë dosjet e vëzhguara nuk ka pasur asnjë rast që të ketë disponuar kthimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë. Nga ana tjetër, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara, palët ndërgjyqëse nuk kanë paraqitur ankim kundër vendimit të dhënë prej tij.

Arsyetimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej tij janë të qarta dhe të kuptueshme. Në çdo rast respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor, ndonëse nuk përdor rregullisht të gjitha karakteret e gjuhës shqipe.

Struktura e vendimeve të tij është e qëndrueshme, e mirorganizuar dhe e standardizuar. Ajo përmban elementet e kërkuara nga legjislacioni procedural, me përjashtim të një rasti, ku në dispozitivin e vendimit nuk janë shënuar të gjitha elementet e kërkuara nga ligji nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e akteve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të kënaqshëm.

Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe u jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore, e cila paraqitet e thjeshtë dhe e kuptueshme. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Në dispozitivin e vendimit, në të gjitha rastet e vëzhguara, është konstatuar se nuk disponohet për shpenzimet procedurale/gjyqësore, si dhe nuk tregohet e drejta e ankimit për palët.

Aftësitë organizative

Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti rivlerësimit, z. Ilir Toska, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013 - 08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Tiranë, në dhomën civile. Ai ka deklaruar se i

janë caktuar për gjykim gjithsej 1224 çështje, ka përfunduar si relator 1062 çështje dhe ka mbartur në vitin e fundit të detyrës 6 çështje. Duke iu referuar këtyre të dhënave, rendimenti i përfundimit të çështjeve është 95.3 %.

Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short për gjyqtarin Ilir Toska, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga dita e marrjes së akteve me short gjer në dhënien e vendimit ka qenë e ndryshme. Kohëzgjatja më e shkurtër ka qenë 16 ditë, ndërsa kohëzgjatja më e lartë ka qenë 1 vit e 7 muaj. Në tri rastet e tjera, gjykimet kanë zgjatur 6 muaj e 12 ditë, 1 muaj e 7 ditë dhe 1 muaj e 13 ditë. Nga analiza e këtyre të dhënave, në raport me standardet kohore për çështjet penale dhe civile në shkallë të dytë, sipas pikës 5, shkronjat “g” dhe “h” të Aneksit I të Sistemit të Vlerësimit, konstatohet se tri çështje janë përfunduar brenda afateve standarde, ndërsa dy të tjera janë përfunduar jashtë afateve standarde. Çështja, që ka pasur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit, prej 1 viti dhe 7 muajsh, ka qenë çështje civile themeli mbi marrëdhënie detyrimi mes palëve, në përfundim është disponuar me vendim themeli. Megjithatë, në analizën e kësaj të dhëne duhet evidentuar se sipas nenit 460/2 të Kodit të Procedurës Civile, seanca e parë gjyqësore në çështjet civile që shqyrtohen në Gjykatën e Apelit caktohen nga kryetari i Gjykatës. Nën këtë analizë, duhet evidentuar se në të 5 rastet e vëzhguara të gjyqtarit Ilir Toska, gjykimet nga seanca e parë gjer në shpalljen e vendimit përfundimtar nuk kanë pasur vonesa.

Në tri dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipastributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Nga analiza e tri dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 14 muaj e 22 ditë, 16 muaj e 18 ditë dhe 17 muaj e 28 ditë.

Si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e dhëna e vetme objektive për këtë fakt. Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shkurtruara, rezultoi se gjyqtari Ilir Toska i kushton rëndësi të veçantë arsyetimit në kohë të shpejtë të vendimeve. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 2 ditë nga shpallja, për 14 ditë nga shpallja, për 5 ditë nga shpallja dhe për 8 ditë. Ndër 5 dosjet e vëzhguara, vetëm një vendim është arsyetuar jashtë afatit ligjor, por edhe në këtë rast vonesa ka qenë e pakët dhe gjithsesi nuk është tejkaluar afati i rekursit prej 30 ditësh.

Së fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, duhet evidentuar se gjyqtari Ilir Toska ka pasur ngarkesë sasiore mbi standardin minimal. Ai ka respektuar afatet standarde të gjykimit të çështjeve që i janë caktuar, si dhe ka arsyetuar pa vonesë vendimet gjyqësore.

Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjeve. 3 prej dosjeve të vëzhguara kanë përfunduar me një seancë, ndërsa 2 dosje të tjera kanë përfunduar me nga dy seanca. Këto të dhëna tregojnë se janë vëzhguar gjithsej shtatë seanca të zhvilluara prej tij. Gjashtë prej këtyre seancave kanë qenë produktive dhe vetëm një seancë ka qenë joproduktive. Në këtë rast, seanca ka dështuar me kërkesë të palëve për t'u njohur me aktet e çështjes. Kjo kërkesë është pranuar pa arsyetim nga gjykata, në kushtet kur palët ishin njoftuar për zhvillimin e seancës rregullisht më shumë se 10 ditë përpara datës së seancës. Në rastet kur gjykimet janë zhvilluar me dy seanca, ato janë caktuar në distanca kohore të arsyeshme nga njëra-tjetra, gjer në 10 ditë.

Nuk ka pasur asnjë seancë të dështuar për shkak të njoftimeve të palëve, ndonëse duhet të dokumentojë më mirë kryerjen e veprimeve. Një tipar i mirë i punës së tij është zhvillimi i seancave gjyqësore gjithnjë në sallë gjykimi, duke e dokumentuar rregullisht këtë veprim. Nga ana tjetër, nga vëzhgimi i 5 dosjeve është konstatuar se tri seanca kanë filluar me vonesë, ku

në dy raste shkak nuk është dokumentuar. Megjithatë, në të tria këto raste, vonesa nuk ka shkakuar pasoja të dukshme.

Ai është i qartë për rolin e Gjykatës së Apelit dhe kryen veprimet e nevojshme procedurale për zgjidhjen e pretendimeve të paraqitura në apelin e palëve. Ndër 5 dosje të vëzhguara, është konstatuar vetëm një rast, kur gjykata ka vendosur riçeljen e hetimit gjyqësor. Po ashtu, në këtë aspekt duhet evidentuar se ndër 5 dosjet e vëzhguara, asnjë rast nuk është kthyer për rigjykim në shkallë të parë. Së fundmi, në këtë aspekt duhet evidentuar se asnjë prej pesë vendimeve të 5 dosjeve të vëzhguara nuk është ankimuar dhe, rrjedhimisht, as nuk është cenuar nga Gjykata e Lartë - pra nuk janë evidentuar gabime gjyqësore të kryera prej tij nga kontrolli gjyqësor i brendshëm.

Aftësia për të administruar dosjet

Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short, është konstatuar se aktet themelore janë të rregullta, të sakta dhe të plota. Procesverbali gjyqësor dokumenton kohën dhe vendin, si dhe veprimet që kryhen në seancë. Gjithashtu, te 5 dosjet janë konstatuar edhe disa mangësi, që janë të njëjta, që tregojnë se bëhet fjalë edhe për metodologji pune. Kështu, në të 5 dosjet gjyqësore nuk ka akte që dokumentojnë caktimin e seancës së parë gjyqësore; aktet e njoftimit të palëve nuk përfshihen rregullisht në dosje; relatimi i gjyqtarit bëhet verbal dhe përmbledhet me një frazë të përgjithshme në procesverbal; nuk dokumentohet shkak i vonësës së seancës gjyqësore; vendimet e ndërmjetme nuk fiksohen në seancë dhe në rastin kur shënohen, nuk tregojnë shkakun ligjor.

Së fundmi, vlen të evidentohet se Formulari i Vetëvlerësimit, i depozituar nga subjekti i rivlerësimit Ilir Toska për procesin e rivlerësimit kalimtar, është i panëshkruar në çdo fletë dhe në fund.

Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale

Etika në punë

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Ilir Toska. Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve, nuk rezultuan të dhëna negative për këtë aspekt. Është e vërtetë që janë konstatuar tri seanca gjyqësore të filluara me vonesë, por kjo e dhënë është vlerësuar tek "Aftësitë organizative të gjyqtarit", pasi nuk rezulton të jetë e lidhur me shkelje të disiplinës në punë.

Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Ilir Toska, dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

Paanësia

Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara, nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Toska. Për vetë gjyqtarin Ilir Toska, në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka pasur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, Ilir Toska, nuk ka respektuar rregullat procedurale.

Sipas të dhënave në dosjen personale, gjyqtari Ilir Toska është diplomuar “Jurist” nga Universiteti Tiranës në datën 27.08.1992. Në datën 15.12.1992 është emëruar gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjirokastrë dhe është liruar me kërkesë të tij, më datë 30.03.2001, nga KLD-ja. Më datë 31.01.2004 është emëruar kryeinspektor në Inspektoratin e KLD-së nga Këshilli Lartë i Drejtësisë. Në datën 30.04.2007 është emëruar gjyqtar në Gjykatën Apelit Tiranë nga KLD-ja, ku vazhdon aktualisht ushtrimin e detyrës. Në periudhën 2012 - 2016, ai është caktuar me short anëtar i Kolegjit Zgjedhor, sipas nenit 146 të Kodit Zgjedhor. Nga këto të dhëna nuk konstatohen pasaktësi në deklaratimet e vetë gjyqtarit në Formularin e Vetëvlerësimit.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës trevjeçare të rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016, për gjyqtarin Ilir Toska janë paraqitur gjithsej 8 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (dy ankesa në vitin 2013, dy ankesa në vitin 2014, dy ankesa në vitin 2015 dhe dy ankesa në vitin 2016). *Asnjë prej këtyre ankesave nuk jep të dhëna negative për veprimtarinë e gjyqtarit gjatë periudhës së rivlerësimit, 8 tetor 2013 - 8 tetor 2016.*

Në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Toska, u mbajtën në vëmendje dhe u analizuan edhe ankesat e shtetasve, si më poshtë:

1. Denoncimi i shtetasit V.Ç. Ankesa drejtohej ndaj 12 gjyqtarëve.
2. Denoncimi i shtetasit L.M. Ankesa drejtohej ndaj 4 gjyqtarëve.
3. Denoncimi i shtetasit A.Ç. Ankesa drejtohet ndaj 7 gjyqtarëve.
4. Denoncimi i shtetasit H.A. Ankesa drejtohej ndaj 4 gjyqtarëve.
5. Denoncimi i shtetasit K.Dh. Ankesa drejtohej ndaj 3 gjyqtarëve.
6. Denoncimi i shtetasit B.B. Ankesa drejtohej ndaj 12 gjyqtarëve.

Ankesa nr. 1.

Në denoncimin e tij, ai shprehet se akuzon 220 gjyqtarë e prokurorë për shpërdorim detyre, pasi kanë dhënë vendime në disfavorin e tij. Duhet bërë prezent fakti se gjyqtari Toska në asnjë rast nuk ka gjykuar ndonjë çështje gjyqësore të këtij shtetasi.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 2.

Në denoncimin e saj pretendon se me vendimin nr. ***, datë 17.03.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë, janë kryer shkelje nga ana e gjykatësve në mënyrë të hapur. Aktualisht, çështja është në Gjykatën e Lartë.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur nga shtetasja L. M., nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 3.

Në denoncimin e tij, ai pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë një vendim jo të drejtë ndaj vajzës së tij, në favor të palës tjetër ndërgjyqëse, që është një kompani sigurimi.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, vërehet se në atë çështje gjyqësore, gjyqtari Toska ka qenë gjyqtar në pakicë, prandaj është i paqartë pretendimi dhe, në këtë rast, nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 4.

Në denoncimin e tij, ai pretendon se subjekti i rivlerësimit ka marrë vendim jo të drejtë dhe të njëanshëm, por duke mos u evidentuar ndonjë shkelje ligjore e kryer në këto raste nga Gjykata

e Apelit, ndërkohë që vendimet e dhëna gjyqësore përmbajnë hollësisht dhe në mënyrë të qartë motivet ligjore të tyre.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 5.

Ky denoncim lidhet me denoncimin nr. 2, që ka të bëjë me dy çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit në vitin 2016 (respektivisht vendimi nr. ***, datë 17.03.2016 dhe vendimi nr. ***, datë 28.09.2016, të Gjykatës së Apelit Tiranë), ku gjyqtari ka qenë anëtar. Në to ngrihen pretendime për vendime të padrejta apo supozohet (ankuesja K.Dh.) se kundërshtari i saj mund të ketë korruptuar gjyqtarët, duke mos u evidentuar ndonjë shkelje ligjore e kryer në këto raste nga Gjykata e Apelit.

Pas shqyrtimit të denoncimit të paraqitur, nuk ka indice për të provuar pretendimet e ngritura.

Ankesa nr. 6.

Ky denoncim lidhet me denoncimin nr. 4, që ka të bëjë me dy çështje të gjykuara në Gjykatën e Apelit në vitin 2010 (respektivisht vendimi nr. ***, datë 05.02.2010 dhe vendimi nr. ***, datë 03.12.2010, të Gjykatës së Apelit Tiranë), ku gjyqtari ka qenë gjyqtar relator. Në to ngrihen pretendime për vendime të padrejta, por duke mos u evidentuar ndonjë shkelje ligjore e kryer në këto raste nga Gjykata e Apelit.

Konstatohet se vendimet e dhëna gjyqësore përmbajnë hollësisht dhe në mënyrë të qartë motivet ligjore të tyre. Për vendimet e dhëna nga Gjykata e Apelit në këto dy raste, nuk ka ndonjë vendim të gjykatave më të larta (Gjykatës së Lartë apo Gjykatës Kushtetuese), që të kenë konstatuar ndonjë shkelje ligjore nga ana e Gjykatës së Apelit.

Konstatohet se të gjashtë ankesat e paraqitura nuk përmbajnë ndonjë të dhënë konkrete në lidhje me kryerjen nga gjyqtari të shkeljeve ligjore në procedurat gjyqësore ku ka marrë pjesë si gjyqtar relator apo anëtar i trupit gjykues.

Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë”.

Trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59/1, germa “c”, të ligjit nr. 84/2016.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar dhe, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “a”, si dhe nenit 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të lartë të vlerësimit të aftësive profesionale,

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Ilir Toska, me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.
2. Ky vendim, i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 21.06.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

KRYESUES

Etleda Çiftja

ANËTAR

Xhensila PINE

RELATOR

Valbona SANXHAKTARI

Sekretare gjyqësore

Anisa Duka